

Zbatimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike

- Gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi

Përmbledhje Ekzekutive

Ligji për Qasje në Dokumente Publike avancoi bazën ligjore në këtë fushë. Ky ligj u miratua më 7 tetor 2010, kurse hyri në fuqi 65 ditë më vonë. Ky afat kohor tejkalon bazën ligjore të përcaktuar me ligjet në fuqi. Edhe pse në letër është avancuar baza ligjore për qasje në dokumente publike, në praktikë gjendja mbetet e njëjtë. Ende nuk është kompletuar korniza ligjore për zbatimin e këtij ligji përmes akteve nënligjore. Ligji dhe Rregullorja për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun nuk po gjejnë zbatim në institucionet publike. Përderisa qasja në dokumente publike është e vështirë në të gjitha institucionet publike, ajo shkon duke u vështirësuar në nivelin lokal, agjencionet e pavarura, ndërmarrjet publike dhe gjykatat. Asnjë institucion nuk ka publikuar kontaktin elektronik të personit përgjegjës për qasje në dokumente publike. Në shumë institucione, personi përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike nuk është pjesë e Zyrës për Komunikim me Publikun, ashtu siç kërkohet me Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun. Madje, në disa komuna, personi që autorizon lejimin e qasjes në dokumente publike është drejtori i administratës komunale. Edhe pse ligji garanton trajtim të barabartë të kërkesave në formë të shtypur dhe atyre elektronike, në praktikë kërkesat elektronike rrallë herë konsiderohen si kërkesa zyrtare. Edhe përkundër ekzistimit të mundësisë që të publikohen dokumentet publike në faqet zyrtare në internet, shumë pak institucione dhe vetëm një numër i vogël i dokumenteve publike janë të qasshme në formë elektronike. Ende nuk ka një udhëzim administrativ i cili definon dokumentet të cilat duhet të publikohen domosdoshmërisht në faqet zyrtare në internet. Shërbyesit civilë kanë njohuri të paktë për përmbajtjen e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Si pasojë e kësaj, norma të caktuara ligjore të këtij ligji edhe keqinterpretohen. Një nga keqinterpretimet e ligjit është edhe aplikimi i pagesave për parashtrimin e kërkesave për qasje në dokumente. Ministria e Financave ende nuk ka nxjerrë rregullore për tarifat për shpenzimet e prodhimit dhe dërgimit të kopjes së dokumenteve. Instituti GAP rekomandon që institucionet publike duhet të caktojnë personat përgjegjës për trajtimin e kërkesave dhe kontaktin e tyre ta publikojnë në uebfaqe. Kërkesat elektronike duhet të trajtohen njësoj sikurse ato të shtypura. Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së Kryeministrit duhet të hartojë raportin vjetor për kërkesat për qasje në dokumente publike dhe të njëjtin t'ia dërgoj Kuvendit, ashtu siç parashihet me ligj. Gjersa Komisioni Parlamentar përkatës duhet të mbajë dëgjim publik me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, ku do të diskutohej ky raporti vjetor.

I. HYRJE

Ligji për Qasje në Dokumente Publike ka hyrë në fuqi gjashtë muaj më parë. Ky ligj zëvendësoi Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare, i cili ishte në fuqi për shtatë vite. Arsyeja për nxjerrjen e një ligji të ri ishte harmonizimi i tij me Kushtetutën e Kosovës, si dhe evitimi i disa pengesave që kanë dalë gjatë zbatimit të këtij ligji në praktikë. Ligji për Qasje në Dokumente Publike avancoi edhe më tutje disa aspekte të ligjit paraprak si:

- Shkurtimi i afatit për përgjigje ndaj kërkesave fillestare nga 15 ditë pune në 7 ditë kalendarike.
- Shkurtimi i afatit për përgjigjet ndaj kërkesave konfirmuese nga 15 ditë pune në 7 ditë kalendarike;
- Caktimi me ligj i njësive/zyrtarëve përgjegjës për të trajtuar kërkesat për qasje në dokumente zyrtare.
- Detyrimi i institucioneve publike që të publikojnë sa më shumë informata në formë elektronike në faqet zyrtare të institucioneve në internet.
- Aplikimi i gjobave për personat fizikë dhe juridikë të cilët pengojnë qasjen në dokumente publike.

Gjatë procedurës për shqyrtimin e Projektligjit për Qasje në Dokumente Publike në Komisionin Parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, Instituti GAP kishte publikuar një analizë dhe kishte dërguar rekomandime konkrete për përmirësimin e përmbajtjes së Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.¹ Kjo analizë e Institutit GAP është vazhdim i punës sonë në monitorimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Përmes kësaj analize, GAP paraqet disa nga pengesat të cilat ia pamundësojnë qytetarëve qasjen në dokumente publike, ashtu siç kërkohet në bazë të Ligjit. Analiza dhe rekomandimet përqendrohen kryesisht në zbatimin e nenit 5 dhe 26 të ligjit (caktimi i njësive/zyrtarëve përgjegjës për të trajtuar kërkesat për qasje në dokumente zyrtare); si dhe, pagesat që aplikohen me rastin e parashtrimit të kërkesave. Në fund të analizës janë dhënë rekomandimet konkrete për institucionet publike se si të përmirësojnë zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, gjegjësisht Rregullores për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun i cili ka hyrë në fuqi më 12 prill 2011.

II. Paqartësitë lidhur me publikimin dhe hyrjen në fuqi të ligjeve

Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Qasje në Dokumente Publike më 7 tetor 2010. Ky ligj u dekretua nga Presidenti më 1 nëntor 2010, kurse u

¹ Analiza e GAP: Qasja në Dokumente Publike, 16 korrik 2010. Mund të shkarkohet nga: [http://institutigap.org/repository/docs/Qasja%20ne%20Dokumente%20Publike\(GAPanalize\).pdf](http://institutigap.org/repository/docs/Qasja%20ne%20Dokumente%20Publike(GAPanalize).pdf)

shpall në Gazetën Zyrtare më 25 nëntor 2010. Ligji ka hyrë në fuqi më 10 dhjetor 2010. Hyrja e Ligjit në fuqi është shtyrë në kohë, në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe Kushtetutën e Kosovës.

Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit në afat prej dhjetë ditë pune nga dita e miratimit.² Sipas këtij rregulli, Kryetari i Kuvendit është dashur ta nënshkruajë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike më së largu më 21 tetor 2010. Në Rregulloren e Punës së Kuvendit nuk thuhet asgjë se sa ditë duhet të kalojnë nga dita e nënshkrimit të ligjit nga Kryetari i Kuvendit e deri në dërgimin e tij tek Presidenti për dekretim.³ Nuk dihet se në çfarë date Presidenti e ka pranuar Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, por ai e ka dekretuar këtë ligj më 1 nëntor 2010. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligji shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës brenda tetë ditësh pasi të ketë marrë ligjin.⁴ Nëse Presidenti, brenda tetë ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur pa nënshkrimin e tij/saj dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.⁵ Sipas këtij rregulli, ligji do të duhej të konsiderohej i shpallur më së largu më 30 tetor 2010, pa nënshkrimin e Presidentit.⁶

Ligji për Qasje në Dokumente Publike është publikuar në Gazetën Zyrtare më 25 nëntor 2010. Sipas Ligjit për Gazetën Zyrtare, të gjitha institucionet janë të detyruara që aktet juridike brenda afatit kohor 5 (pesë) ditor nga dita e nxjerrjes, t'i dërgojnë në Zyrën për Publikimin të Gazetës Zyrtare.⁷ Sipas kësaj, Ligji për Qasje në Dokumente Publike i dekretuar nga Presidenti do të duhej të arrinte në Zyrën për Publikimin të Gazetës Zyrtare më së largu më 6 nëntor 2010. Sipas Ligjit për Gazetën Zyrtare, kjo Zyre duhet të publikojë aktet ligjore brenda 15 ditësh nga dita e pranimi të tyre.⁸ Si rrjedhojë, Ligji për Qasje në Dokumente Publike do të duhej të publikohej më së largu më 20 nëntor 2010.

Si përfundim, në rastin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, koha nga miratimi i tij në Kuvend e deri tek hyrja e tij në fuqi ka zgjatur mbi dy muaj dhe ky ligj, së paku nëse bazohemi në afatet e parapara ligjore, do të duhej të hynte në fuqi 5-6 ditë më herët se sa realisht ka hyrë në fuqi.⁹ Gjithashtu, respektimi i dispozitës ligjore, ashtu siç specifikohet në nenin 26, paragrafi 2, ku thuhet që Qeveria duhet të miratojë aktet nënligjore tre

² Neni 61, paragrafi 1, i Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, miratuar më 20 prill 2010.

³ Paragrafi 2 i nenit 62 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës thotë: "Ligji i nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit i dërgohet Presidentit të Republikës për shpallje." Por nuk ceket afati kohor brenda sa kohësh duhet që Kryetari i Kuvendit t'ia dërgoj Presidentit ligjin për shpallje.

⁴ Neni 80, pika 2, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

⁵ Neni 80, pika 5, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

⁶ Në rast se Ligji i nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit do ti dërgohej Presidentit menjëherë më 21 apo 22 tetor 2010.

⁷ Neni 7, paragrafi 7, i Ligjit nr.03/L-190 për Gazetën Zyrtare.

⁸ Neni 12, paragrafi 1, i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

⁹ Sipas Ligjit për Gazetën Zyrtare, neni 9, paragrafi 2, "Institucionet vendore kanë të drejtë të kërkojnë sqarime nga Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare lidhur me vonesën eventuale të publikimit të aktit juridik në Gazetën Zyrtare." Ky sqarim nuk është kërkuar nga ana e Kuvendit të Kosovës.

muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit nuk është bërë.¹⁰ Nëse kemi parasysh, datën e hyrjes në fuqi të ligjit, dhe poashtu të Rregullores për Shërbimin e Komunikimit me Publikun, i cili është ka hyrë në fuqi më 12 prill 2011, rezulton që Qeveria nuk e ka respektuar nenin në fjalë, pra është vonuar 52 ditë!

III. Zyrtarët/njësitë për trajtimin e kërkesave për Qasje në Dokumente Publike

Për të lehtësuar procesin e miratimit të kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente publike, Ligji për Qasjen në Dokumente Publike, gjegjësisht neni 5 i tij, obligon të gjitha institucionet publike të caktojnë njësinë apo zyrtarin përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave. Të gjitha kërkesat për qasje në dokumente i drejtohen njësisë apo zyrtarit për komunikim me qytetarë të institucionit përkatës. Po ashtu, neni 26 specifikon që 3 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit, të nxjerren aktet nënligjore. Si rrjedhojë, më 12 prill ka hyrë në fuqi Rregullorja për Shërbimin e Komunikimit me Publikun i cila përcakton themelimin dhe funksionimin e një sistemi koherent dhe të koordinuar për të komunikuar, për publikun, politikat dhe aktivitetet nga ana e institucioneve publike.¹¹

Rregullorja e re përcakton rolet dhe funksionet e Zyrave për Komunikim me Publikun për institucionet publike si në vijim:

1. Qeverinë si tërësi, duke përfshirë Zyrën e Kryeministrit dhe Ministritë;
2. Agjencitë Ekzekutive Qeveritare apo njësitë përkatëse në nivel të tyre në vartësi të Zyrës së Kryeministrit apo ministrive përkatëse dhe;
3. Komunat.

Para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, institucionet publike kishin caktuar përgjegjësit e autorizuar (kryesisht në Zyrat e Arkivit) për të pranuar kërkesat për qasje në dokumente publike. Tani, me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, Zyrat për Marrëdhënie me Publikun obligohen që këta zyrtarë t'i caktojnë brenda zyrave të tyre. Mirëpo, deri më tani, kjo rregullore ende nuk është vënë në zbatim nga asnjë institucion i obliguar sipas rregullores. Zyrtarët e autorizuar për pranimin e kërkesave për qasje në dokumente publike vazhdojnë të mos jenë të angazhuar brenda Zyreve për Marrëdhënie me Publikun por mbeten ashtu siç ishin edhe më parë; zyrtarë të arkivës duke përfshirë edhe raste kur këtë përgjegjësi e ushtrojnë edhe

¹⁰ Neni 26, paragrafi 2, i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

¹¹ Neni 1, i Rregullores për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun. Kjo rregullore do të shfuqizojë Rregulloren Nr. 03/2007 për Themelimin dhe Funksionet e Shërbimit të Përhershëm të Komunikimit Qeveritar në Kosovë.

Drejtorë të Administratës brenda komunave (Rasti i Komunës së Kamenicës).

Neni 6 i kësaj rregulloreje, përcakton poashtu strukturën organizative të Zyrës për Komunikim Publik brenda institucioneve të cilat i specifikon, ku thuhet që në këtë strukturë duhet të jetë, ndër të tjera, edhe zyrtari përkatës për pranimin e kërkesave në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare.

Sa i përket institucioneve tjera të pavarura nga ekzekutivi si: Ndërmarrjet publike, Gjykatat dhe Agjencitë e pavarura që i raportojnë Kuvendit, vlen neni 5 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, gjegjësishtë përcaktimi i personit përgjegjës për pranimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

III.A. INSTITUCIONET QENDRORE

Të gjitha institucionet qendrore i kanë të autorizuar personat përgjegjës për qasje në dokumente publike. Adresat e tyre elektronike janë zyrtare, mirëpo këto adresa nuk figurojnë në asnjërën faqe elektronike të institucionit përkatës. Ndërsa, adresat e zyrtarëve për marrëdhënie me publikun i posedon secila ministri në faqet e tyre zyrtare.

Institucioni	A ka person përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike? Nëse po, çfarë funksioni tjetër kryen?	A është publikuar në uebfaqe emri dhe kontakti i personit përgjegjës për qasje në dokumente publike?	E-mail
Kuvendi	Mikel Mirakaj	Jo	mikel.mirakaj@assembly-kosova.org
Presidenca	Taulante Berisha	Jo	taulante@president-ks.gov.net
Zyra e Kryeministrit	Shqipe Hasimja	Jo	shqipe.hasimja@ks-gov.net
Ministria e Administratës Publike	Nijazi Biqkaj	Jo	nijazi.biqkaj@ks-gov.net
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Nora Hyseni	Jo	nora.hyseni@ks-gov.net
Ministria e Drejtësisë	Ibadete Qehaja	Jo	ibadete.qehaja@ks-gov.net

Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Zoja Sutaj	Jo	zoja.sutaj@ks-gov.net
Ministria e Financave	Afërdita Shehu	Jo	aferdita.shehu@mef-rks.org
Ministria e Forcës së Sigurisë	Elhami Hoxha	Jo	elhami.hoxha@ks-gov.net
Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal	Bashkim Bardoniqi	Jo	bashkim.bardoniqi@ks-gov.net
Ministria e Punëve të Brendshme	Nazlije Ajeti	Jo	nazlije.ajeti@ks-gov.net
Ministria e Punëve të Jashtme	Bekim Misimi	Jo	bekim.misimi@ks-gov.net
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Hidajete Gashi	Jo	hidajete.gashi@ks-gov.net
Ministria për Komunitete dhe Kthim	Valbona Ratkoceri	Jo	valbona.ratkoceri@ks-gov.net
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Xhafer Cakolli	Jo	xhafacakolli@hotmail.com
Ministria e Infrastrukturës	Mustafa Gara	Jo	mustafa.gara@ks-gov.net
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Fatmire Tahiri	Jo	fatmire.tahiri@ks-gov.net
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Ardita Qallapeku	Jo	ardita.qallapeku@ks-gov.net
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Feti Berisha	Jo	feti.berisha@ks-gov.net
Ministria e Integritetit Europian	Evgjenije Preteni	Jo	evgjenije.preteni@ks-gov.net
Ministria e Shëndetësisë	Makfire Zeneli	Jo	makfire.zeneli@ks-gov.net

III.B. AGJENCIONET E PAVARURA

Situatë e njëjtë qëndron edhe me agjencionet e pavarura, ku të gjitha adresat elektronike të marra janë ato zyrtare të agjencioneve përkatëse mirëpo personat kompetentë/njësitë për qasje në dokumente publike nuk figurojnë në faqet elektronike. Nga 11 agjencionet e pavarura që janë kontaktuar, 9 prej tyre kanë dhënë emrat dhe adresat e personave përgjegjës për trajtimin e kërkesave, gjersa 3 institucione nuk kanë qenë në gjendje të japin një emër dhe një adresë të personit për trajtimin e kërkesave.

Institucioni	A ka person përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike? Nëse po, çfarë funksioni tjetër kryen?	A është publikuar në uebfaqe emri dhe kontakti i personit përgjegjës për qasje në dokumente publike?	E-mail
Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART)	Albina Berisha	Jo	albina.berisha@art-ks.org
Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)	Agim Uka	Jo	agim.uka@kpm-ks.org
Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK)	Suzana Pllana	Jo	suzana.pllana@ks-gov.net
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës	Miran Zeneli	Jo	miran.zeneli@ks-gov.net
Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit (AKK)	Shpresa Kurshumliu	Jo	shpresa.kurshumliu@ks-gov.net
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	Gjejlane Hoxha	Jo	gjejlane.hoxha@ks-gov.net
Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës (ASHAK)	-	Jo	-
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)	Leonora Morina	Jo	leonora.morina@pak-ks.org
Agjencia Kosovare e Pronës	-	Jo	-
Avokati i Popullit	Mentor Myftari	Jo	myftari@ombduspersonkosoovo.org
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)	Fehmi Ajvazi	Jo	fehmi.ajvazi@kqz-ks.org
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	-	Jo	-

III.C. KOMUNAT

Në shumicën e komunave të kontaktuara, është konfirmuar nga personat përgjegjës se ekzistojnë zyra të arkivit dhe personat e tyre përgjegjës. Në disa prej tyre Shefi i Administratës luan rolin kryesor sa i përket qasjes në

dokumente publike, siç është rasti në Gjakovë, Kaçanik, Kamenicë etj. Janë shumë të pakta rastet e përdorimit të adresave elektronike zyrtare, shumica prej tyre përdorin ato personale. Dhjetë nga 37 Komunitet e Kosovës nuk kanë caktuar person përgjegjës për trajtimin e kërkesave, gjersa një komunë ka dhënë emrin e personit përgjegjës, por jo edhe adresën e tij elektronike.

Institucioni	A ka person përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike? Nëse po, çfarë funksioni tjetër kryen?	A është publikuar në uebfaqe emri dhe kontakti i personit përgjegjës për qasje në dokumente publike?	E-mail
Prishtinë	Nefi Krasniqi	Jo	nefikrasniqi@hotmail.com
Mitrovicë	Fikrije Maxhuni	Jo	-
Deçan	Ibish Gërvalla	Jo	ibish.gervalla@rks-gov.net
Dragash	-	Jo	-
Gjakovë	Mark Komani	Jo	mark.komani@ks-gov.net
Drenas	Kajtaž Kastrati	Jo	kajtažkastrati07@hotmail.com
Graçanicë	-	Jo	-
Gjilan	Fetush Haliti	Jo	fatushehaliti@hotmail.com
Istog	Xhevahir Ibrahimaj	Jo	xhevahirebrahimaj@hotmail.com
Kaçanik	Ilir Teneqja	Jo	ilir.teneqja@ks-gov.net
Kamenicë	Enver Ajvazi	Jo	enver_ajvazi@hotmail.com
Klllokot	Refik Halili	Jo	refikhalili@hotmail.com
Klinë	Gani Krasniqi	Jo	Nuk ka
Fushë Kosovë	-	Jo	-
Leposaviç	-	Jo	-
Lipjan	Ali Peçani	Jo	ali_peqani@live.com
Malishevë	-	Jo	-
Novobërdë	Sylejman Avdyli	Jo	sylejmanavdyli@hotmail.com
Obiliq	-	Jo	-
Rahovec	Nehat Krasniqi	Jo	neki_krasniqi@hotmail.com
Ranillug	-	Jo	-
Partesh	-	Jo	-
Pejë	Ramë Dervishi	Jo	rame.dervishi@yahoo.com

Podujevë	Hakif Namani	Jo	hakif.namani@ks-gov.net
Prizren	Ymer Berisha	Jo	ymer.berisha@ks-gov.net
Skenderaj	Hamit Geci	Jo	hamit.geci@ks-gov.net
Shterpcë	Dalibor Jevtic	Jo	dalibor.jevtic@ks-gov.net
Shtime	Remzie Zeqiri	Jo	rrjedha_r@hotmail.com
Suharekë	Haxhi Mamaj	Jo	-
Ferizaj	Afrim Matoshi	Jo	afrimmatoshi@hotmail.com
Viti	Abdyrrahim Sadiku	Jo	-
Vushtri	Sabri Xhaferi	Jo	sabri.xhaferi@hotmail.com
Zubin Potok	-	Jo	-
Zveçan	-	Jo	-
Mamushë	Sergie Sokol	Jo	sergiesokol@hotmail.com
Junik	Muhamet Gacaferi	Jo	-
Hani i Elezit	Bashkim Sopa	Jo	bashkim.sopa@ks-gov.net

III.D. NDËRMARRJET QENDRORE DHE LOKALE

Edhe ndërmarrjet publike kanë njësitë/personat kontaktues për qasje në dokumente publike. Zyrtat për marrëdhënie me publikun në shumicën prej tyre e kanë për detyrë edhe pranimin e kërkesave për qasje në dokumente publike. Shumica prej tyre përdorin adresa elektronike zyrtare por ka edhe raste kur këta zyrtarë përdorin edhe adresat e tyre private. Tetë nga 31 ndërmarrjet publike (lokale dhe qendrore) nuk kanë caktuar personat përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

Institucioni	A ka person përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike? Nëse po, ëfarë funksioni tjetër kryen?	A është publikuar në uebfaqe emri dhe kontakti i personit përgjegjës për qasje në dokumente publike?	E-mail
KEK	-	Jo	-
Hekurudhat e Kosovës	Melgyme Fetahu	Jo	melgyme.fetahu@kosovorailëa.com
KOSTT	Hajrie Zeka	Jo	hajrie.zeka@kostt.com
ANP	Myrvete Carani	Jo	myrvetecarani@airportpristina.com

Komp. për menaxhimin e deponive	-	Jo	-
NPH Iber Lepenc	-	Jo	-
RTK	Hysen Hundozi	Jo	hysenhundozi@rtklive.com
Komp. e Ujitjes Drini i Bardhë	Milazim Shatri	Jo	milazimshatri@hotmail.com
Komp. e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini	-	Jo	-
Komp. Rajonale e Ujësjesit Prishtina	-	Jo	-
Komp. Rajonale e Ujësjesit Hidrodrini (Pejë)	-	Jo	-
Komp. Rajonale e Ujësjesit Hidroregjioni Jugor	-	Jo	-
Komp. Rajonale e Ujësjesit Mitrovica	-	Jo	-
Komp. Rajonale e Ujësjesit Hidromorava	-	Jo	-
Komp. Rajonale e Ujësjesit Radoniqi	Vjosa Radogoshi	Jo	vjosaradogoshi@yahoo.com
Ngrohtorja e Qytetit Sh.A. Prishtine	-	Jo	-
Ngrohtorja e Qytetit Gjakova	-	Jo	-
Kompania Rajonale e Mbeturinave Çabрати Sh.A	-	Jo	-
Kompania e Mbeturinave JKP Standard	-	Jo	-
Kompania e Mbeturinave JKSP Zveçan	-	Jo	-
Kompania e Ujësjesit dhe Mbeturinave Ibri	-	Jo	-
Kompania e	-	Jo	-

Ujësjiellësit dhe Mbeturinave 24 Nëntori			
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Bifurkacioni Sh.A	Nazmi Asllani	Jo	n_asllani1@hotmail.com
Ndërmarrja Publike Banesore	Beqir Berisha	Jo	b-beqa2002@hotmail.com
NP Tregu, Mitrovicë	-	Jo	-
Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi Sh.A	-	Jo	-
Kompania Rajonale e Mbeturinave Ambienti Sh.A	-	Jo	-
Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastërtia	-	Jo	-
Kompania Rajonale e Mbeturinave Eco-Regjioni	-	Jo	-
Kompania Rajonale e Mbeturinave Higjiena	-	Jo	-
Kompania Rajonale e Mbeturinave Uniteti	-	Jo	-

III.E. GJYKATAT DHE PROKURORITË

Qasja në dokumente publike është shumë më e vështirë në Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës. Të rralla janë rastet që i përdorin adresat elektronike zyrtare, të gjitha adresat e marra elektronike janë private. Në shumicën e Gjykatave, Administratori i Gjykatës përkatëse luan rolin kryesor për pranimin dhe lëshimin e dokumenteve të ndryshme. Ndërsa sa i përket Gjykatave për Kundërvajtje në shumicën e gjykatave të kontaktuara nuk

kanë fare zyra të arkivit, problem shumë i madh i cilësuar edhe nga vet kontaktuesit e gjykatave për kundërvajtje. Ndërsa Gjykata Komunale dhe ajo për Kundërvajtje e Skenderajt nuk përdorin fare adresat elektronike.

Institucioni	A ka person përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike? Nëse po, çfarë funksioni i jetër kryen?	A është publikuar në uebfaqe emri dhe kontakti i personit përgjegjës për qasje në dokumente publike?	E-mail
Gjykata Supreme	Ajna Gashi	Jo	ajnagashi@hotmail.com
GJLK/Prishtinë	Sabit Hamiti	Jo	sabithamiti@hotmail.com
Gjykata Kushtetuese	Naser Hasani	Jo	naserhasani@ks-gov.net
Gjykata Komunale - Prishtinë	-	Jo	-
Gjykata e Qarkut - Prishtinë	Feriz Berisha	Jo	feriz-berisha@hotmail.com
Gjykata Ekonomike -Prishtinë	Nusret Arifi	Jo	nusret.arifi@hotmail.com
Gjykata për Kundërvajtje - Prishtinë	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Podujeve	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje- Podujevë	Ismet Ahmeti	Jo	ismetahmeti@yahoo.com
Gjykata Komunale (GJK)- Lypjan	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Lipjan	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Drenas	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Drenas	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Kacanik	Ramadan Gutaci	Jo	ramadan.gutaci@hotmail.com
Gjykata për	Xhevdet Guri	Jo	xhevdetguri@hotmail.com

Kundërvajtje - Kacanik			
Gjykata e Qarkut - Gjiilan	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Gjiilan	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Gjiilan	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Viti	Azem Zejnullahu	Jo	azjenullahu@hotmail.com
Gjykata për Kundërvajtje - Viti	Qazim Shabani	Jo	qazim_shabani@hotmail.com
Gjykata Komunale - Ferizaj	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Ferizaj	Bahri Hashari	Jo	bahrijashari@hotmail.com
Gjykata Komunale - Kamenicë	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Kamenicë	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Shtërpce	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Shtërpce	-	Jo	-
Gjykata e Qarkut - Prizren	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Prizren	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Prizren	Nexhibe Bala	Jo	nexhibebala@hotmail.com
Gjykata Komunale - Suharekë	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Suharekë	Durmish Berisha	Jo	durmishberisha@hotmail.com
Gjykata Komunale - Malishevë	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Malishevë	Hajredin Morina	Jo	hajredinmorina56@hotmail.com
Gjykata Komunale - Rahovec	-	Jo	-
Gjykata për	-	Jo	-

Kundërvajtje - Rahovec			
Gjykata Komunale - Dragash	-	Jo	2.kurteshi-gjykata@hotmail.com
Gjykata për Kundërvajtje - Dragash	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Pejë	Esat Shala	Jo	esatshala@hotmail.com
Gjykata për Kundërvajtje - Pejë	Izel Iljazi	Jo	izeliljazi@hotmail.com
Gjykata Komunale - Pejë	Sadedin Gacaferi	Jo	sadedin.gacaferi@hotmail.com
Gjykata Komunale-Gjakovë	Rudin Elezi	Jo	rudin_elezi@hotmail.com
Gjykata për Kundërvajtje - Gjakovë	Vlora Deva	Jo	vloradeva@gmail.com
Gjykata Komunale - Deçan	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Decan	Gjerojne Alaj	Jo	gjejronealaj@hotmail.com
Gjykata Komunale - Istog	Jahir Kamberaj	Jo	jahirkamberaj@hotmail.com
Gjykata për Kundërvajtje - Istog	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Klinë	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Klinë	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Mitrovicë	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Mitrovicë	-	Jo	-
Gjykata e Qarkut - Mitrovicë	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Skenderaj	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Skenderaj	-	Jo	-
Gjykata Komunale - Vushtri	-	Jo	-
Gjykata për Kundërvajtje - Vushtri	-	Jo	-
Gjykata Komunale -	-	Jo	-

Leposaviq			
Gjykata për Kundërvajtje - Leposaviq	-	Jo	-
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Zoja Gashi	Jo	zojagashi01@yahoo.com
Instituti Gjyqësor i Kosovës	Drita Kurteshi	Jo	drita.kurteshi@ks-gov.net
Këshilli Prokurorial i Kosovës	-	Jo	-
Prokuroria e Shtetit	-	Jo	-
P.P.K Prishtinë	-	Jo	-
P.P.K Ferizaj	-	Jo	-
P.P.K Prizren	-	Jo	-
P.P.K Pejë	-	Jo	-
P.P.K Gjakovë	-	Jo	-
P.P.K Gjilan	-	Jo	-
P.P.K Mitrovicë	-	Jo	-

IV. Trajtimi i kërkesave elektronike

Ligji për Qasje në Dokumente Publike i jep rëndësi të barabartë kërkesave në të shkruar dhe atyre elektronike.¹² Mirëpo, në praktikë, dërgimi i kërkesave në formë elektronike është i pamundur në shumë raste. Mos publikimi i emrave dhe adresave elektronike të personave përgjegjës për trajtimin e kërkesave, i pamundëson qytetarëve parashtrimin e kërkesës në formë elektronike në adresën e duhur.

Kurse në rastet kur një gjë e tillë është e mundur, shumë institucione kërkojnë që kërkesa të dërgohet në formë të shtypur dhe e protokoluar dhe nuk i pranojnë kërkesat në formë elektronike.

Sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, ministria përkatëse për administratë publike, më së largu gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit, nxjerrë akt nënligjor për formën, dukjen dhe karakteristikat tjera që duhet të kenë ueb faqet e institucioneve publike.¹³

Një udhëzim i tillë ende nuk është nxjerrë.¹⁴ Ministria e Administratës Publike duhet të nxjerrë sa më parë një udhëzim të tillë dhe, ndër të tjera, t'i obligojë institucionet publike që në uebfaqen e tyre të publikojnë emrin e zyrtarit/njesisë përgjegjëse për qasje në dokumente publike, së bashku me adresën elektronike zyrtare.

¹² Neni 6 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike: "Kërkesat për qasje në dokumente parashtrihen në çfarëdo mënyrë e cila i mundëson institucionit publik të identifikojë dokumentin."

¹³ Neni 16 pika 4 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

¹⁴ Sipas zyrtarëve përgjegjës në Ministrinë e Administratës Publike, një udhëzim i tillë është duke u hartuar.

Çështje tjetër që duhet të adresohet me udhëzimin administrativ për përmbajtjen e uebfaqeve të institucioneve publike, janë edhe adresat elektronike (e-mailat) e personave publik. Siç mund të shihet nga tabelat e mësipërme, disa nga personat përgjegjës për qasje në dokumente publike komunikojnë me adresa private që përfundojnë me: @gmail.com, @hotmail.com apo @yahoo.com.

Kjo nuk është forma më e mirë e komunikimit, për shkak se pjesa më e madhe e shërbyesve civilë kanë edhe emailat e tyre zyrtar, të cilët në të shumtën e rasteve përfundojnë me @ks-gov.net.

Të gjithë shërbyesit civil, gjatë komunikimit zyrtar, duhet të përdorin emailat e tyre zyrtar. Praktika më e mirë për të siguruar një kontinuitet dhe adresë të përhershme për të adresuar kërkesat do të ishte nëse institucionet kanë një email institucional për të parashtruar kërkesat.¹⁵

V. Pagesat për Kërkesat për Qasje në Dokumente Publike

Kërkesat për qasje në dokumente publike dhe dokumentet e ofruara janë pa pagesë. Një tarifë mund t'i ngarkohet kërkuarit për kopje të dokumentit, e cila është e arsyeshme dhe nuk mund të tejkalojë shpenzimet e vërteta të riprodhimit dhe furnizimit të dokumentit. Tarifat për shpenzimet e prodhimit dhe dërgimit të kopjes së dokumenteve rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga ministria përkatëse për financa dhe janë unike për të gjitha institucionet publike. Tarifat e ngarkesave duhet të publikohen.¹⁶

Ka institucione publike të cilat obligojnë parashtruesit e kërkesës që të paguajnë për parashtrimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.¹⁷ Një shembull i tillë është Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Çdo kërkesë për qasje në informatat e këtij Agjencioni kushton 2 euro. Përveç që pagesa prej 2€ duhet të bëhet përmes bankës, gjithashtu duhet paguar 1€ shtesë për kryerjen e shërbimit.

¹⁵ Për shembull, Kuvendi i Kosovës do të mund të krijojë një adresë elektronike, si informatazyrtare@kosovo-assembly.org. Ky email do të mund të përdorej gjithnjë, nga çdo person i cili caktohet përgjegjës për trajtimin e kërkesave. Një adresë e tillë do të ishte e qëndrueshme edhe në rastet kur personi përgjegjës për qasje në dokumente publike ndërro funksion brenda organizatës apo largohet nga puna.

¹⁶ Neni 21 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

¹⁷ Në analizën e Institutit GAP "Qasja në Dokumente Publike" e korrikut 2010, kemi paraqitur katër raste kur na është kërkuar që të paguajmë për parashtrimin e kërkesës për qasje në dokumente publike. Analiza e GAP: Qasja në Dokumente Publike, 16 korrik 2010. Mund të shkarkohet nga: [http://institutigap.org/repository/docs/Qasja%20ne%20Dokumente%20Publike\(GAPanalize\).pdf](http://institutigap.org/repository/docs/Qasja%20ne%20Dokumente%20Publike(GAPanalize).pdf)

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrië - Ministry of Trade and Industry
AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT / AGENCIJA ZA UPIS BIZNISA /
BUSINESS REGISTRATION AGENCY

FATURË - RAČUN - INVOICE
Nr.ser - Ser.br. - Ser.no
0054390

REGJISTRIMI I BIZNESIT / UPIS BIZNISA / BUSINESS REGISTRATION

Emri i biznesit
Naziv biznisa
Name of business
INSTITUTI GAP

Përshkrimi
Opis
Description
Kërkuesi për qasje në informata publike të Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve

Shuma
Iznos
Amount
€ 1000400070002411

Me fjalë
Rečima
In words
Dy mijë

Llogaria bankare
Broj žiroračuna
Bank account
1000400070002411

Lëshuar nga
Izdato od
Issued by

Kodi i të hyrës
Kod Prihoda
Incoms Code
50204

- Regjistrim
- Ndryshim
- Shuarje
- Tjera

NLB Prishtina sh.a.
13 MAY 2011

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat bankë
Bank signature and stamp

UNIREF

Dëshmia e pagesës për parashtrimin e kërkesës për qasje në informatat publike të Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve, 13 maj 2011.

Kjo praktikë është në kundërshtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Institucionet publike përgjegjëse për monitorimin e zbatueshmërisë së këtij ligji, duhet të evidentojnë praktikta e tilla dhe t'i evitojnë ato.¹⁸

Ministria e Financave nuk ka nxjerr udhëzimin administrativ për tarifat për shpenzimet e prodhimit dhe dërgimit të kopjes së dokumenteve, ashtu siç parashihet me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

VI. Ankesat pas refuzimit të kërkesës për qasje në dokumente publike

Në rast të mos realizimit të kërkesës për qasje në dokumente publike dhe kur parashtruesi i kërkesës mendon se refuzimi për qasje është bërë në kundërshtim me Ligjin, ligji parasheh edhe të drejtën e ankesës tek Avokati i Popullit, gjykata kompetente apo institucionet tjera publike.¹⁹

Mirëpo asnjë nga këto institucione nuk ka ndikuar efektivisht që qasja në dokumente publike të avancohet tutje. Avokati i Popullit deri më tani nuk ka mundur të shtyjë tutje ankesat për mos lejimin e qasjes në dokumente

¹⁸ Një nga këto institucione mund të jetë edhe Komision Parlamentar për Arsim, Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media.

¹⁹ Neni 10 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

publike. E vetmja mundësi ligjore që ka ky institucion, është që t'i evidencojë shkeljet që janë bërë me rastin e mos realizimit të të drejtës për qasje në dokumente publike dhe t'i publikojë ato në raportin e tij vjetor që i dërgohet Kuvendit. Më efikase nuk janë treguar as gjykatat. Për shkak të jo transparencës së gjykatave, nuk dihet numri i saktë i padive që qytetarët kanë deponuar pas refuzimit të kërkesës për qasje në dokumente publike.²⁰

Sipas Ligjit, parashihet që njësia përkatëse në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të përgatisë një raport vjetor për vitin paraprak dhe të njëjtin t'ia dërgojë Kuvendit më së largu deri në janar. Në ligj nuk ceket se cila është kjo njësi. Pas kërkesave të Institutit GAP për të pasur qasje në këtë raport, kërkesa jonë është ri orientuar disa herë në mes të Zyrës Ligjore, Zyrës për Informim dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë. Kjo na lë të kuptojmë se asnjëra nga këto njësi nuk i është ngarkuar kjo detyrë e përgatitjes së raportit vjetor për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Një raport i tillë nuk i është dërguar as Kuvendit të Kosovës.²¹ Nevojitet që me anë të një akti nënligjor të caktohet njësia përgjegjëse në kuadër të Zyrës së Kryeministrit e cila do të ketë për detyrë përgatitjen e këtij raporti, si dhe elementet që duhet të përmbajë një raport i tillë.

²⁰ Rasti më i njohur është ai i "Lëvizjes FOL". Kjo organizatë jo qeveritare ka deponuar padinë pranë Gjykatës Komonale të Prishtinës, pas refuzimit të dyfishtë nga Ministria e Transportit për të pasur qasje në kontratën e autostradës me konsorciumin Bechtel&Enka. Edhe pas një viti të deponimit të padisë, kjo organizatë nuk ka marrë asnjë përgjigje nga institucionet kompetente.

²¹ Një raport i tillë vjetor nuk ka arritur në Kuvend deri më datën 17 maj 2011.

Përfundime

1. Hyrja në fuqi e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike është vonuar më shumë se që realisht e lejon dispozitat ligjore në fuqi. Ligji ka hyrë në fuqi 64 ditë pas miratimit të tij në Kuvend.
2. Zëvendësimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike ka përmirësuar bazën ligjore për qasje në informacionin publik. Mirëpo në praktikë gjendja nuk ka ndryshuar për të mirë.
3. Qasja në dokumente publike është e vështirë në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Mirëpo, nëse bëjmë një krahasim në mes institucioneve, qasja në dokumente publike është më e vështirë në agjencionet e pavarura, ndërmarrje publike dhe sidomos në institucionet gjyqësore, përderisa gjendje më e kënaqshme ekziston në institucionet qendrore.
4. Një numër i madh i institucioneve nuk kanë caktuar personin/njësine përgjegjëse për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, ashtu siç kërkohet edhe me nenin 5 të Ligjit. Asnjë institucion nuk ka publikuar në faqen e tij zyrtare në internet emrin e personit/njesisë përgjegjëse dhe adresën elektronike për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.
5. Zyra për Komunikim me Publikun në kuadër të Zyrës së Kryeministrit nuk ka përpiluar raportin përfundimtar vjetor për kërkesat e parashtruara në të gjitha institucionet publike, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe Rregulloren nr.03/2011 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun.
6. Shërbyesit civilë nuk kanë njohuri të mjaftueshme apo keqinterpretojnë dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Si rrjedhojë kërkesat elektronike në praktikë nuk e kanë rëndësinë e njëjtë sikurse kërkesat e shtypura; dhe aplikohen pagesa për parashtrimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.
7. Institucionet zbatuese, mbikëqyrëse dhe gjyqësore, siç janë Avokati i Popullit dhe gjykatat, deri më tani janë treguar jo efikase sa i përket trajtimit të ankesave që lidhen me kufizimin/refuzimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.

Rekomandime

1. Institucionet publike, sidomos Kuvendi i Kosovës, të kërkojë përgjegjësi nga Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare për vonesat

që janë shfaqur në publikimin e ligjeve, siç është rasti me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

2. Ministria e Administratës Publike të nxjerrë sa më parë udhëzimin administrativ për përmbajtjen e faqeve zyrtare në internet, ashtu siç kërkohet me nenin 16 pika 3 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Udhëzimi administrativ duhet të obligojë institucionet publike që në faqen e tyre zyrtare në internet të publikojnë emrat e personave/njësive përgjegjëse për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, së bashku me adresën e tyre elektronike. Gjithashtu me udhëzim duhet të ndalohet përdorimi i emailave privat në komunikim zyrtar.
3. Zyra për Komunikim me Publikun, në fund të çdo viti kalendarik, të përgatisë raportin për gjendjen sa i përket qasjes në dokumente publike dhe i njëjti t'i durohet?? Kuvendit jo më larg se deri në fund të janarit të vitit pasardhës, ashtu siç kërkohet edhe me ligj.
4. Kuvendi i Kosovës të hedh në debat publik Raportin Vjetor për Qasje në Dokumente Publike të përgatitur nga Zyra për Komunikim me Publikun, ku ftohen mediat dhe organizatat qeveritare që të japin vlerësimin e tyre për gjendjen reale dhe përmbajtjen e Raportit Vjetor.
5. Ministra e Financave të nxjerrë udhëzimin administrativ për tarifat për shpenzimet e prodhimit dhe dërgimit të kopjes së dokumenteve dhe të publikohet në faqen zyrtare të ministrisë në internet dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
6. Komisioni Parlamentar për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media të luajë rol aktiv në monitorimin e përmbajtjes së udhëzimeve administrative që parashihen të nxirren sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Komisioni të kërkojë nga ministritë kompetente që të dërgojnë aktet nënligjore për diskutim në këtë komision, me qëllim që të njëjtat respektojnë përmbajtjen e ligjit dhe lehtësojnë qasjen në dokumente publike.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti për Studime të Avancuara GAP përkrahet nga:



Kjo analizë është përkrahur nga:

